

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Nesrin Lushta, kryetare, Emine Mustafa dhe Rasim Rasimi, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të pandehurve B.G. dhe H.H., secili veç e veç nga dy veprave penale keqpërdorimi i pozitës ose autoritetit zyrtar nga neni 422 par.2 nënpar.2.2 lidhur me par.1 të KPK, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, të paraqitur nga Prokurori i Shtetit të Kosovës kundër aktgjyimit të Gjykatës Themelore Gjilan - DKR, PKR.nr.54/2017 datë 5.6.2017 dhe aktgjyimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.325/2017 datë 28.8.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më 10 prill 2018, mori këtë

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e Prokurorit të Shtetit të Kosovës, paraqitur kundër aktgjyimit të Gjykatës Themelore Gjilan - DKR, PKR.nr.54/2017 datë 5.6.2017 dhe aktgjyimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.325/2017 datë 28.8.2017.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Gjilan – DKR, PKR.nr.54/2017 datë 5.6.2017, të pandehurit B.G. dhe H.H., janë liruar nga akuza për shkak secili veç e veç nga dy vepra penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.2 nënpar.2.2 lidhur me par.1 të KPK. Është vendosur që shpenzimet e procedurës penale të bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit të Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.325/2017 datë 28.8.2017, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e Prokurorit të Shtetit, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjytimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur Prokurori i Shtetit të Kosovës, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal me propozim që të konstatohet se aktgjykimet e kundërshtuara përmbajnë shkelje të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të ligjit penal.

Ndaj kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të pandehurit nuk kanë dhënë përgjigje.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes, vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë në pajtim me dispozitën e nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK, dhe konstatoi se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Në kërkesë potencohet se gjykatat nuk e kanë bazuar vendimin e tyre në zbatimin e ligjeve dhe akteve të domosdoshme për vendosjen e kësaj çështjeje penale. Theksohet se në rastin konkret është shkëlur ligji nr.04/L-144 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, statuti i spitalit rajonal të Gjilanit dhe procesverbali për pranimin teknik të pajisje mjekësore Grafi-Digjitale i datës 13.1.2016. Më pas në kërkesë Prokurori i referohet nenit 5 të ligjit të lartcekur të cilin e interpreton për të theksuar se të pandehurit kanë lidhur kontratën me “K... SHPK” dhe “K...V...”, operator këta të cilët nuk kanë paguar borxhet e mëparshme e që dokumentohet nga faturat në shkresat e çështjes, prandaj manifestohen elementet e veprës penale nga neni 422 par.2 nënpar.2.2 të KPPK, pra, moskryerja me dashje të ndonjë detyre të domosdoshme të përcaktuar me ligj. Më pas, Prokurori citon segmentet nga deklaratat e të pandehurit B.G. të dhënë në Prokurori më 12.4.2016 dhe deklaratën e H.H. të datës 13.4.2016, duke theksuar se këta dy kanë pranuar se vendimi për dhënien në shfrytëzim të hapësirës për kantinë nuk ka qenë rezultat i procedurës së tenderimit siç parasheh dispozita e nenit 5 të ligjit të cituar më lartë e më pas thekson se sipas kontratës ka qenë e paraparë ngritja e një objekti montazh, ndërsa nga shkresat e çështjes dhe foto dokumentacioni rezulton se objekti është i ndërtuar me material të fortë-bloka të betonit.

Gjykata Supreme, vlerëson të pabazuara pretendimet e mësipërme nga këto arsye:

Nga shkresat e çështjes dhe aktgjykimet e kundërshtuara rezulton se me aktakuzën PPH/I.nr.65/2016 datë 30.3.2016, sipas pikës I i pandehuri B.G. dhe H.H., secili veç e veç janë akuzuar për nga dy vepra penale keqpërdorimi i pozitës ose autoritetit zyrtar nga neni 422 par.2 nënpar.2.2 lidhur me par.1 të KPK, sepse B.G. në cilësinë e personit zyrtar – Drejtor ekzekutiv në Spitalin e Përgjithshëm në Gjilan,

duke tejkualuar autorizimet e veta me qëllim nuk i ka kryer detyrat e përcaktuara me ligj ashtu që edhe pse I.S., pronari i objektit "V..", nuk ka pasur kontratë për shfrytëzimin e hapësirës e pjesës së oborrit të spitalit, gjatë vitit 2015 nuk ka ndërmarrë masa për ndalimin e veprimtarisë-respektivisht mbylljen e lokalit deri në përfundim të procedurave të tenderimit, por ka vazhduar që të kryejë pagesat për shpenzimet e rrymës dhe ujit si ka qenë e specifikuar në kontratat e mëhershme deri në dhjetor të vitit 2014 dhe me këtë ka dëmtuar buxhetin e spitalit regjional në Gjilan. H.H. në cilësinë e drejtorit të administratës në spitalin e përgjithshëm në Gjilan, i cili ka qenë i caktuar me vendim si anëtar i komisionit lidhur me hapjen dhe shqyrtimin e ofertave sipas ftesës për ofertë të datës 21.1.2016, nuk i ka përmbushur detyrat e tij zyrtare, me qëllim të përfitimit të çfarëdo dobie të kundërligjshme, me dashje nuk ka kryer detyrat ashtu që edhe për kundërt faktit se ka qenë në dijeni se objekti Kantina "V.." i cili ka qenë i vendosur në oborrin e spitalit dhe ndërtuar nga materiali i fort ndaj të cilit ka qenë në procedurë padija për pagesën e borxhit në shumën prej 5.000 €, i njëjti propozon të pandehurit të parë që me këtë operator ekonomik të lidh kontratë mbi qiranë duke u thirrur vetëm në faktin se ky operator ka ofruar çmimin më të lartë. Sipas pikës III të aktakuzës të pandehurit B.G. dhe H.H., si persona zyrtar duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin, kanë tejkualuar kompetencat e tyre zyrtare ashtu që me dashje nuk kanë kryer detyrat e domosdoshme të përcaktuara me ligj me rastin e pranimit të aparaturës "G...D...OE" kanë lëshuar mjetet operatorit ekonomik "K...M..", me 16 janar 2016 shumën prej 55.000 €, edhe pse paraprakisht është dashur që të bëhet testimi dhe pranimi teknik i aparatit.

Edhe pse baza e këtij mjetei juridik janë shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, në kërkesë përveç që theksohet se gjykatat vendimet e tyre nuk e kanë bazuar në zbatimin e ligjeve për vendosjen e kësaj çështjeje, nuk jep arsye se cilat janë ato shkelje dhe cilat dispozita konkrete ligjore janë shkelur prandaj, ky pretendim u refuzua si i pabazuar sepse konform dispozitës së nenit 436 par.1 të KPPK, është paraparë se me rastin e vendosjes mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, Gjykata Supreme e Kosovës kufizohet vetëm me verifikimin e shkeljeve ligjore në të cilat paraqitësi i kërkesës pretendon.

Pretendimin tjetër të Prokurorit lidhur me shkeljen e nenit 5 të Ligjit nr.04/L-144 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme kjo Gjykatë vlerëson si të pabazuar për faktin se neni 5 të ligjit të cituar më lartë, në të cilën thirret Prokurori i Shtetit, ka përcaktuar procedurat për dhënien të pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim të afatshkurtër, e cila sipas këtij neni duhet të realizohet përmes konkurrencës së hapur publike dhe procedurave të parapara me këtë ligj.

Nga shkresat e çështjes rezulton se në rastin konkret procedura për dhënien e pronës në shfrytëzim të përkohshëm është bërë në përputhje me ligjin. Në rastin

konkret del se këtu paraprakisht është shpallur ftesë për ofertë me nr. të referencës 01-71 i datës 21.1.2016 (një konstatim i këtillë qëndron edhe në dispozitivin II të aktakuzës dhe aktgjykimit) me ç'rast janë paraqitur tre ofertues. Më pas me vendimin e drejtorit ekzekutiv – të pandehurit të parë B.G., të datës 2.2.2016 është formuar komisioni për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, komision ky në përbërje prej H.H., Dr. A.K. dhe L.M. dhe pas vlerësimit të dokumentacionit është përzgjedhur ofertuesi më i mirë – i përshtatshëm operatori SHPK “K...” me pronar A.S., të cilin operator ka rekomanduar komisioni që i pandehuri i parë të nënshkruajë kontratën. Fakti i cili pretendohet në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë se objekti në fjalë është ndërtuar me material të fort ndërtimor nuk mund të atribuohet të pandehurve sepse është evidente se kemi të bëjmë me një objekt të përkohshëm.

Qëndron fakti se operatori “K...” sipas deklaramit të dëshmitarit F.S. – zyrtar i prokurimit në Spitalin Regjional në Gjilan, ka operuar në oborrin e spitalit me kontrata të përtërirë edhe gjatë vitit 2014 deri më 2016 kur është kërkuar që të tenderohet çështja e shfrytëzimit të objektit – të tokës. Sipas këtij dëshmitari nga viti 2014 dhe 2015 janë përsëritur dy tendera për këtë qëllim, meqë nuk ka pasur ofertues. Gjatë kohës sa kanë dështuar tenderët, kantina ka funksionuar në oborr të spitalit me kontratë të përtërirë. Nuk ka qenë kontestues fakti se ky operator për vitin 2015 kishte një borxh prej 5.500 €, mirëpo, ky borxh nga pronari I.S., është përmbuar më 28.9.2015 pas ujdisë gjyqësore në mes të tij dhe Spitalit të Përgjithshëm, prandaj ky borxh është paguar paraprakisht para se të filloj procesi i tenderimit të fundit dhe nuk mund të atribuohet fituesit të tenderit A.S., siç potencohet në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë sepse këtu kemi të bëjmë me një person tjetër. Nga ana tjetër i pandehuri B.G., është emëruar si UD Drejtor i Spitalit më 5.10.2015, ndërsa më 1.3.2016 është zgjedhur në pozitën e drejtorit të spitalit në Gj..

Pretendimi i radhës nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është shkelja e procesverbalit për pranimin teknik të pajisjes mjekësore-Grafi Digjitale i datës 13.1.2016 respektivisht neni 9 nën par. 9.4 i cili citohet: “në rast të nënshkrimit të kontratave nga paragrafi 9.3, spitali paraqitet si subjekt i pavarur juridik dhe afarist bazuar në ligjin për Prokurim Publik dhe ligjeve të nxjerra nga Ministria për Ekonomi dhe Financa”.

Kjo Gjykatë vlerëson se as pretendimi në fjalë nuk është i bazuar se Prokurori i Shtetit, përveç citimit nuk specifikon se në çfarë forme është shkelur procesverbali gjegjësisht dispozita e cituar.

Megjithatë, nga shkresat e çështjes dhe arsyet e dhëna në aktgjykimin e shkallës së parë të paraqitur në faqen 14 dhe 15 rezulton si i pakontestueshëm fakti se Spitali në Gj. në fund të vitit 2015 është furnizuar me aparat “G..D..OE” që rezulton

nga kontrata e lidhur në mes të spitalit dhe "K...M." SHPK nga P., më datë 17.8.2015 në shumë prej 55.000 €.

Pranimi teknik i aparatit, nuk ka mundur të bëhet në fund të vitit 2015 për shkak të mungesës të një anëtari të komisionit të caktuar Dr. Sh.R., bio inxhinierë e cila në dhjetor ishte jashtë vendit, kështu që kjo procedurë është kryer më 13.1.2016 në bazë të garancionit bankar (sipas kontratës 702 15 29 121 i datës 23.12.2015), ndërsa pagesa e aparatit është bërë më 16 janar 2016 fakt ky që nuk ka qenë kontestues, pra është bërë pikërisht në përputhje me kontratën e nënshkruar, respektivisht nenin 2 pika 2.3 ku qëndron konstatimi se totali i kontratës do të paguhet pas instalimit të pajisjes, lëshimit në punë dhe trajnimit të stafit për përdorim të drejt të pajisjes.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se konkludimet e dy gjykatave janë të drejta dhe të bazuara në ligj, kjo për arsye se nuk është kontestues fakti se të dy të pandehurit janë persona zyrtar në Spitalin e Përgjithshëm në Gjilan. Megjithatë, nga shkresat e çështjes, madje edhe nga përshkrimi faktik të veprave penale nga aktakuza, nuk ka ndonjë përshkrim preciz dhe konkret të veprimeve inkriminuese të cilat i kanë ndërmarr të pandehurit që do të ndërlidheshin me përgjegjësinë dhe detyrat e tyre si personat zyrtar. Përkundrazi, nga provat e administruara, madje as nga përshkrimi i veprimeve të pandehurve të dhënë në aktakuzë, nuk rezulton se në rastin konkret të pandehurit veprimet e tyre zyrtare i kanë ndërmarr në kuadër të dispozitës së nenit 422 par.2 nën par.2.2 lidhur me par.1 të KPK.

Nga arsye të dhëna më sipër, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë u refuzua si e pabazuar dhe në kuptim të nenit 437 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË
Pml.nr. 320/2017, më 10 prill 2018

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetare e kolegjit,
Nesrin Lushta